



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA IV**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr. 73.**  
**Prishtinë, më 11.07.2013 në ora 13:30**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Vesna Mikić, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

**Munguan:** Jasmina Živković dhe Glauk Konjufca.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit,** zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Elmi Reçica**, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-209 për Amnistinë;**

**Kryesuesi** - konstatoi se janë përmbushur kushtet procedurale për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi** – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-209 për Amnistinë;**

**Kryesuesi** –e informoi Komisionin për domosdoshmërinë e mbajtjes së kësaj mbledhjes në procedurë të përshpejtuar, për shkak të dinamikës së paraparë rreth procedimit të Projektligjit në lexim të dytë në Seancë Plenare të Kuvendit, të përcaktuar për sot.

Në fjalën e tij tha se në përfundim të debatit në Seancë Plenare, deputetët me shumicë votash, me 91 "për", 17 "kundër" dhe 1 apstenim, miratuan në parim Projektligjin për amnistinë.

Njëkohësisht, i ftoi të pranishmit që të njëjtin ta miratojnë pa vërejtje, sepse ky Projektligj nuk përmban dispozita që i dëmtojnë interesat e komuniteteve, prandaj edhe u përkrah njëzërit.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzërit, nxori këtë:

### ***R E K O M A N D I M***

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Amnistinë nr. 04/L-209 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Kryesuesi**- i njoftoi anëtarët e Komisionit se me propozim të Grupit Parlamentar SLS dhe Grupit Parlamentar ZB, në mbledhjen plenare të mbajtur më 27 qershor dhe 4 korrik 2013, është marrë vendim të emërohet deputetja Vesna Mikic- anëtare e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetit Goran Marinkovic.

Njëherit i shprehu mirëseardhje znj Mikic, dhe shprehu mendimin e tij se do të kemi bashkëpunim të mirë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Zëvendëskryetar i parë i Komisionit**

---

**Elmi Reçica**